



Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 34 (2 dhe 3) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Nenet: 7 dhe 9, Komuna Podujevë shpall:

---

## Konkurs

### Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

---

|                          |  |
|--------------------------|--|
| <b>Emri i grupit</b>     | Specialistë të inxhinierisë të Ndërtimit |
| <b>Institucioni</b>      | Komuna Podujevë                          |
| <b>Nr. i Referencës</b>  | RN00011616                               |
| <b>Kodi</b>              | RPC0005233                               |
| <b>Data e njoftimit</b>  | 08.05.2023                               |
| <b>Afati për aplikim</b> | 29.05.2023 - 05.06.2023                  |

---

## 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

---

- Të kontrollojë produktet ndërtimore, pajisjet, aparatet, repromaterialin për prodhim, përpunim dhe finalizim, si dhe prodhimet në të gjitha fazat e prodhimit dhe në të gjitha vendet ku gjenden dhe dokumentacionin tjetër përkatës të nevojshëm me qëllim të mbikëqyrjes së zbatimit të dispozitave ligjore;
- Merr pjesë në inspektimin e objektet ndërtimore për të verifikuar dokumentacionin e nevojshëm rreth ndërtimit të objektit sidomos për leje ndërtimore;
- Të hyjë në çdo kohë gjatë orarit të punës, në prani të drejtuesit apo përfaqësuesit të tij, në reparte, linja prodhimi e shfrytëzimi dhe qendra tregtimi ku ushtrojnë veprimtari subjektet e përshkuara me ligj;
- Mbikëqyrë punën e pjesëmarrësve në ndërtimin, modifikimin, përdorimin, mirëmbajtjen dhe rrënimin e ndërtesave, si dhe cilësisë së përdorimit të produkteve të ndërtimit;
- Me rastin e inspektimit në objekte ndërtimore harton procesverbale me shkrim;
- Kujdeset për aplikimin e fletëparaqitjeve për kundërvajtje;
- Lëshon urdhëresa dhe ndalesa të përkohshme sipas rregullave ligjore për evitimin e parregullsive apo të mungesave gjatë kryerjes së punëve për një afat të caktuar kohor;
- Ndërmerr masat e sigurisë për ndalimin e ndërtimeve pa leje;
- Merr pjesë në komisione kur ngarkohet, kryen detyrat përkatëse si dhe detyra të tjera që mund të ngarkohen nga mbikëqyrësi në përshtatje me natyrën e punës dhe profesionit të tij.

## 2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

---

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

## 3. Kërkesat e përgjithshme formale

---

a) Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve, Inxhinieri Ndërtimi, Inxhinieri Civile.

b) Kualifikime të posaçme formale: Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitat e kësaj klase.

c) Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.





## 9. Fusha e njohurive, cilësive dhe aftësive që do të vlerësohen

---

-Në testimin me shkrim, kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme të kërkuara për Grupin Specialistë të Inxhinierisë së Ndërtimit.

- Vlerësimi i jetëshkrimit konsiston në vlerësimin e cilësisë dhe nivelit të arsimit, të përvojës domethënëse në punë dhe të trajnimeve që lidhen me vendin e punës në lëminë përkatëse të lidhur me Grupin Specialistë të Inxhinierisë së Ndërtimit.

- Në intervistë, vlerësohen njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për Grupin Specialistë të Inxhinierisë së Ndërtimit që nuk mund të vlerësohen nëpërmjet testimit me shkrim.

## 10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

---

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 11. Shpallja e rezultateve përfundimtare

---

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

### Të dhëna shtesë:

<https://www.youtube.com/watch?v=olwDDqCUeZI>

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

